

[illegible]

“Banimi Social Adekuat” - hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të jetesës

Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nënshkruan memorandumit e mirëkuptimit për projektin “Banimi Social Adekuat”. Ky projekt do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të banimit për familjet dhe për individët në nevojë, duke përfshirë:

- Rindërtimin e njësive të reja për banim social;
- Rindërtimin apo përmirësimin e shtëpive private për familjet e cenueshme.

Shënohet Dita e Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”

Në Ditën e Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”, Komuna e Rahovecit, familjarët e qytetarë të tjerë, kujtuan jetën dhe veprën e Sulejman Krasniqit, këtij shkrimtari dhe atdhetari të madh, i cili me penën dhe me përkushtimin e tij i dha frymë dhe zemër dashurisë për atdheun.

Për të nderuar këtë figurë madhore, Komuna e Rahovecit dha çmimin letrar “SULEJMAN KRASNIQI”, për vitin 2024.

Pas përcaktimeve të kriterëve të vlerësimit nga komisioni profesional, u nxorën këto përfundime:

Vendi I - poezia “Mungesë”, shifra: 0001;

Vendi II - tregimi (proza) “Si të vrasësh nëpërmjet dashurisë”, shifra: Pseudo L;

Vendi III - poezia “Etje e pashuar”, shifra: Milosao.



Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi ceremoninë e dhënies së mirënjohjeve, dekoratave dhe çmimeve për sportistët e komunës sonë, duke nderuar arritjet dhe sukseset e tyre përgjatë vitit 2024. Po ashtu, me mirënjohje u nderuan bizneset që kanë mbështetur financiarisht dhe moralisht sportistët dhe klubet sportive, duke kontribuar në zhvillimin e sportit në komunën tonë.

